




BIORAT-i RODENTICID BIOLOGJIK
KUNDRA MINJVE

IDEASS KUBA

Inovacione për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Jug - Jug



Hyrje

Teksti i shkruar nga **Daniel Morhaim y Reinaldo Espino Llerena**

BIORAT-i është një produkt rodencil natyral, i cili ka një efektivitet shumë të lartë kundër dëmeve që shkaktojnë minjtë. Që prej kohrave të lashta, zhvillimi i vendosjeve humane është shoqëruar gjithnjë me këto dëme, të cilat kanë ndikuar në formë direkte, si në drejtim të shkatërrimit të shëndetit njerëzor ashtu dhe në aktivitetet ekonomike, duke arritur deri në krijimin e situatave të padurueshme për vetë habitatin.

Ky brejtës ka patur aftësinë t'i adaptohet kushteve të ekzistencës nga më të pakrahasueshmet dhe ndërkohe është shtrirë në mënyre te padiskriminueshme në të gjitha krahinat. Ky fenomen është përkeqësuar edhe nga veprimi i njerëzve të cilët gjatë zhvillimit të përcaktimit të vendodhjes së tyre si dhe zhvillimit të aktivitetit të tyre ekonomik kanë provokuar disekuilibre të vazhdueshme ekologjike, të shoqëruara me ndërprerje të njëpasnjëshme të balanceve natyrale, dhe e gjitha kjo ka shkaktuar një rritje të pakontrolluar të popullimeve të këtyre brejtësve në të gjithë botën.

Keta brejtës janë luftuar tradicionalisht në mënyrë jo efektive nëpërmjet përdorimit të metodave nga më të ndryshmet të cilat kanë qënë që nga përndjekja fizike deri tek kurthet mekanike apo elektrike të ngritura, ashtu sikurse dhe nëpërmjet përdorimit të substancave kimike toksike që u sugjeruan fillimisht gjatë shekullit XX si një alternativë kontrolli. Këto substanca aplikohen që prej dekadash në një formë anarkike dhe intensive, të cilat provokojnë rritjen e ndotjes së mjedisit sikurse provokojnë dhe dëme serioze tek specie të tjera kafshësh tëndjeshme ndaj këtyre substancave, gjithashtu dhe tek vetë njerëzit.

Në përgjigje të kesaj problematike, Laboratorët Biologjik Farmaceutik LABIOFAM të Kubës kanë prodhuar një rodenticid biologjik, duke u nisur nga një mikroorganizëm patogjen specifik të minjve, dhe që u veçua nga fundi i shekullit XIX. Në këtë mënyrë u arrit prodhimi BIORAT i cili është i vetmi produkt aktual në treg që garanton:

- një efikasitet të lartë e demonstruar kjo në kontrollin e minjve si në zonat urbane, ashtu dhe në ato industriale dhe rurale, në kushte aplikimi dhe në kushte klimaterike nga më të ndryshmet
- parrezikshmërinë totale në drejtim të specieve të tjera kafshësh
- një sjellje jo invazive në ambient dhe tepër i shpërbërshëm biologjikisht
- hapsirë në përdorimin e vazhdueshëm për shkak të veprimit të tij multiplikator.
- një rreze të gjerë veprimi, falë aftësisë për të transmetuar efektet e veta ngjithëse.



Autorët e BIORAT janë doktorët Reynaldo Espino Llerena, José A. Fraga Castro dhe Juan G. Bornote Romero.

Ky produkt është përdorur në mënyrë të suksesshme në 22 vënde të ndryshme të shpërndarë në Amerikën Latine, Afrikë, Azi dhe Europë. Përdorimi i tij është përqëndruar në luftën e suksesshme kundër dëmeve nga minjtë. Kjo është realizuar si në formë të planeve të shëndetit parandalues në situata konkrete të epidemive të murtajes Bubonike, Leptospirosis, Fiebre (Temperatura) Hemorrágica, Tifo Murino dhe Hanta Virus, ashtu dhe në kontrollin e dëmeve në kulturat e ndryshme bujqësore, depo dhe industri.

Gjatë përdorimit dhe zbatimit të tij, që filloi në Kubë që prej vitit 1985, BIORAT ka përfituar njohje të shumta prej njësive nacionale dhe internacionale. Në Kubë, BIORAT u njoh nga Zyra Kubane e Pronësive Industriale dhe nga ministri të ndryshme nacionale. Jashtë vendit, BIORAT është i njohur nga Institucione Publike të Shëndetit dhe të Bujqësisë, nga Ndërmarrje private dhe Agjensi të specializuara të Sistemit të Kombeve të Bashkuara, siç janë OPS/OMS, FAO dhe PNUD-i.

Duke u nisur nga këndvështrimi i pronës industriale, BIORAT ndodhet i regjistruar në 21 vende dhe procesit të tij teknologjik i është dhënë Patenta Internacionale. Është vlerësuar nga Instituti i Mjekësisë Tropikale "Pedro Kourí", njësi reference kjo e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.



Çfarë problemesh zgjidh?

Nga fundi i shekullit XIX, gjatë investigimeve mbi epidemitë brenda popullimit të minjve, u izolua në Europë një bakterie e identifikuar si shkaktarja e një sëmundje vdekjeprurëse, e cila paraqiste një kuadër klinik të tifos së zorrëve. Gjatë shumë viteve u kryen sforco për të zhvilluar një produkt të një forme industriale që të lejonte shfrytëzimin e të mirave të atij mikroorganizmi për luftën kundër minjve, por gjithnjë pa u shoqëruar këto sforco nga suksesi. Paralelisht, u zhvilluan produkte të tjerë me bakterie të të njëjtes familje si ajo që ishte veguar, por për shkak të zhvillimit fillestar shkencor të atyre kohëve u përzgjedhën disa nga ato që nuk ishin specifike për minjtë, dhe që provokuan në atë epokë dëme dhe infeksione në specie të tjera kafshësh.

Duke nisur prej vitit 1967 dhe deri në vitin 1985 u realizuan investigime mbi këtë agjent, të përkrahura në fillimet e tyre nga Akademia e Shkencave të Kubës dhe më pas nga Ndërmarrja (Kompania) e Laboratorëve Biologjik Farmaceutik LABIOFAM. Këto arritën kulmin në mënyrë të suksesshme në vitin 1985 me përfitim të këtij produkti. Në këtë datë filloi prodhimi në shkallë industriale dhe aplikimi i tij në fushatat e shëndetit parandalues të Kubës.

Produkti BIORAT përftohet nga kombinimi i tre komponentëve:

- Karemi tërheqësi (cebo) është një substance atraktive për minjtë që i tërheq për të konsumuar produktin. Për këtë qëllim u provuan lloje të ndryshme, duke vendosur përdorimin e orizit me guackë për shkak të aftësive qiellëzore të këtyre kafshëve si dhe të lehtësisë së gjetjes së tij (orizit) praktikisht në të gjithë botën.
- Mikroorganizmi është një patogjen specifik me karakteristikën e mëposhtme: Shtami: Salmonella enteritidis; Plásmidi: 59, 4, 3 Mda; Fagotipi: 6^a; Karakteristika Biokimike diferenciale: Lisina negative. Karakteristika më relevante e theksuar është se i jep ekskluzivitetin për ndikimin e tij vetëm tek brejtësit dhe është plásmidi i 59 Mda, që posedon gene të virulencës (spv) e që jep virulencë specifike për keto specie. Duhet nënvizuar se bakteriet e kësaj familje që janë patogjene tek njerëzit dhe tek speciet e tjera të kafshëve posedojnë plásmide 30, 36 dhe 38 ashtu si dhe fagotipe 4, 8, 13 dhe 13a, asnjë prej të cilave nuk ndodhen prezente tek shtami (ajo që është përdorur fillimisht) e përdorur për zhvillimin e BIORAT.
- Immunodepresori është një substancë potenciale me bazë kripërash aromatike të kumarines (cumarina), e cila duke u përdorur në përqendrim të ulta, redukton mbrojtjen imunitare të brejtësit, në sulm ndaj bakteries që ndodhet në produkt.




Nga pikëpamja e pronës industriale, BIORAT gjendet i regjistruar në 21 vende dhe procesit të tij teknologjik i është dhënë Patenta Internazionale. Është vlerësuar nga Instituti i Mjeksisë Tropikale “Pedro Kourí”, njësi reference e Organizatës Boeterore të Shëndetësisë. Ekziston një dosje e plotë e provave si klinike dhe laboratorike ashtu dhe ato të fushës ku është realizuar produkti.

Biorat lejon në këtë mënyrë të realizohet një kontroll biologjik i kolonive të minjve, duke u nisur nga avantazhet e mëposhtme:

- Vrasja e minjve vetëm me një aplikim
- Është efektive në të gjitha rastet, përfshirë dhe rastet e kolonive të brejtësve rezistentë ndaj antikoagulantëve (anticoagulantes).
- Nuk shkakton xhelozira tek tërheuësi.
- Nuk prek as njerëzit as kafshët shtëpiake, për këtë arsye në rast të helmimit aksidental nuk është e nevojshme për kundërhelm.
- Është palatable (e pranueshme për qiellzën) tek minjtë, dhe brejtësit nuk kanë nevojë të shkojnë në kërkim të ujit, pasi është vetë tërheuësi i BIORAT që e siguron këtë.
- Prodhon një epizooti vdekjeprurës tek brejtësit duke prekur gjithashtu dhe ata që nuk e kanë konsumuar.
- Duke qënë se është i shpërbërshëm biologjikisht nuk ndot mjedisit.
- Nuk krijon rezistencë as kundërshtim midis minjve
- Në vende ku ka konkurrencë me ushqime të tjera, është i preferueshëm nga minjtë
- Dy aplikime në vit i mbajnë nën kontroll popullatat.

Aktualisht paraqiten në të gjithë botën një seri ndikimesh si në aspektin ekonomik ashtu dhe në atë sanitar për shkak të këtyre brejtësve, pasi nga pikëpamja sanitare këto infektive janë të lidhura me përhapjen e 60 sëmundjeve të ndryshme. Për sa i përket impaktit të tij, humbjet nga këto brejtës arrijnë në më shumë se 2000 milion dollarë USD, ose ajo që është ekuivalente në afërsisht 4% të prodhimit.





Biorat-i në praktikë

Kjo metodë e kontrollit të minjve aplikohet në praktikë duke ndjekur metodën e realizimit të fushatës kundra minjve. Objektivi i fushatave të zhdukjes së minjve është kontrolli i popullimit të tyre deri në atë nivel që nuk shkaktojnë rreziqe për shëndetin dhe ekonominë. Ky kontroll mund të konsistojë në rregulla të përgjithshme në dy tipe objektivash:

- objektivat bujqesore, që janë ato që lidhen me kulturat bujqësore
- objektivat urbane; duke i grupuar këto si në ato që konsistojnë në ndërtesat që destinohen për banim ashtu dhe industrinë, depot, zonat e shpërndarjes (argëtimit) dhe të tjera që ekzistojnë brenda perimetrit të zonave urbane.



SHKALLA E INFEKSIONIT QE TREGOJNE KERKESEN E NEVOJAVE PER KONTROLL

- Zonat urbane: shkalla e infeksionit mbi 10%
- Zonat bujqësore: Indeksset mbi 10% ose dëmet më të mëdha se 3% të vlerës

Aktualisht në Kubë, plantacionet që prezantojnë preken më të madhe nga pikëpamja e ndikimit ekonomik janë kulturat e arrës së kokosit, kallam sheqerit, graminacet dhe kafesë.

ETAPAT E NJE FUSHATE KUNDER MINJVE

- Njohja. Kjo nënkupton vizitën në lokalitete nga ana e personelit teknik të ekipit dhe bërjen e skicës së zonave, duke treguar për zonat urbane numrin e shtëpive të banimit, të depove, impjanteve industriale, zonave të hapura etj, ashtu si dhe rrugët dhe hyrjet për tek komunitetet si dhe numrin e banorëve. Për zonat rurale përcaktohen tipet e kulturave dhe zonat e tyre, numri i banesave, depove, impjanteve industriale, zonave të hapura, rrugëve dhe hyrjeve etj.
- Tipi i brejtësit. Përcaktohen speciet e minjve që ekzistojnë në një vend të infektuar
- Kërkesat. Duke ndjekur numrin e shtëpive të banimit dhe/ose instalimet dhe zonat e secilit lokalitet ose zonën dhe vecoritë e kulturave, llogariten nevojat për cdo prej tyre.
- Logjistika. Në këtë etapë do të procedohet me blerjen e sasive të nevojshme të produktit dhe për shpërndarjen e tij; do të vendosen pajisjet dhe furnizimet e tjera të nevojshme për realizimin e punës dhe përgatitjen e personelit të nevojshëm për fushatën
- Zbatimi. Në këtë moment do të procedohet me aplikimin e BIORAT-it sipas planit të bërë për këtë çështje.
- Vlerësimi. Së fundi, do të procedohet me vlerësimin e rezultateve të fushatës si dhe me përgatitjen e projektit të etapave të ndjekjes së zhdukjes së minjve si një aktivitet permanent dhe i qëndrueshëm


PROGRAMIMI I AKTIVITETEVE SIPAS ETAPAVE

AKTIVITETET	JAVET			
Për zonat urbane				
• Koordinimi me autoritetet Rajonale, Nacionale dhe Lokale	X			
• Intervista dhe mbledhje pune me drejtimet ekzekutive të hapsirave të përzgjedhura	X			
• Aftësimi i autoriteteve lokale, si dhe drejtuesve të komuniteteve	X			
• Përcaktimi i dëmeve dhe i shkalla e infektimit	X	X		
• Aplikimi i rodenticidit	X	X	X	
• Vlerësimi dhe Raporti i Rezultateve	X	X	X	X
Për zonat rurale				
• Koordinimi me njësite e interesuara	X			
• Intervista dhe mbledhje pune me drejtimet ekzekutive të hapsirave të përzgjedhura	X			
• Aftësimi i personelit të përzgjedhur	X			
• Përcaktimi i dëmeve dhe i shkalla e infektimit	X	X		
• Aplikimi i rodenticidit	X	X	X	
• Vlerësimi dhe Raporti i Rezultateve	X	X	X	X

Rezultatet praktike që janë përfuar në 18 vjet eksperiencë në përdorimin e BIORAT janë të lidhura direkt me zonën specifike në të cilën është aplikuar ai, pasi këto ndikojnë në mënyre decizive në efektivitetin final të aplikimit.

Mesataret e përfuara, që demonstrohen në vazhdim, janë mesatare që janë regjistruar në lokalitete të ndryshme, dhe tregojnë efektivitetin e lartë të përgjithshëm të produktit.

ZONAT E APLIKIMIT	EFEKTIVITETI I PERFTUAR (%)
Zonat urbane të mbyllura	99
Zonat urbane mikse	95
Zonat industriale dhe depot (magazinat)	98
Kulturat bujqësore	93



Rezultatet

Biorat gjëndet i regjistruar dhe është përdorur në 12 vënde të Amerikës qëndrorë dhe jugore, 3 vënde afrikane dhe 7 vënde të Euroazisë. Përdorimi i këtij produkti është shtrirë shumë për arsyet e mëposhtme:

- Është një produkt i parrezikshëm për speciet e tjera ashtu sikurse edhe për njeriun dhe mjedisit.
- Lejon, për shkak të karakterit të vetë produktit i cili ka një teknologji të lartë, të rrisë njohuritë mbi mekanizmat dhe format biologjike të kontrollit të dëmeve (sëmundjeve) si midis personelit që merr pjesë në përdorimin e tij ashtu dhe në popullsinë që obzervon efektet përfituese të metodës.
- Zgjon interesin e autoriteteve sanitare dhe të drejtuesve të kompanive për metoda që veçohen nga ato të përdorura tradicionalisht të cilat kanë qënë pak efikase.
- E meriton njohjen e të interesuarve për arsye të përfitimeve që sjell për shëndetin
- Lejon të rritet shpejt rendimenti i aktiviteteve ekonomike në të cilat aplikohet
- Është i qëndrueshëm, për shkak të komponentëve të përdorur për prodhimin e tij, si dhe përftohet lehtë në cdo vend të botës.



Kostoja — fitimi i përdorimit të produktit ilustron me faktin se për të trajtuar një hektar gjatë 1 viti duhet të investohet nëpërmjet përdorimit të produkteve kimike tradicionale (me rezultate shumë të dobëta dhe dëme mbi ekosistemin) rreth 150% deri 300% në krahasim me burimet e nevojshme që duhen kur përdor BIORAT për të njëjtën sipërfaqe.

Rezultatet janë efektive dhe pa efekte dytësore.

Dita 1	Aplikimi I BIORAT
Dita 4	Fillimi i ngordhjeve
Dita 14	Fundi i ngordhjeve në formë direkte
Dita 30	Fundi i ngordhjeve për shkak të Epizootise
Efektiviteti	93 deri në 99%
Aplikimi i ri BIORAT	midis 6 muajsh deri në 1 vit



Interesi ndërkombëtar

Për arsye të avantazheve të padiskutueshme që prezanton kjo metodë kontrolli i brejtësve nëpërmjet përdorimit të BIORAT, organizata të ndryshme si nacionale ashtu dhe internacionale kanë promovuar përdorimin e këtij rodenticidi.

Në hapësirat nacionale, mbështetjen për përdorimin e tij e bëjnë Ministrinë e Shëndetësisë të vendeve të ndryshme si në nivel qendror ashtu dhe në nivel lokal dmth. provincash apo komunitetesh.

Në radhë të dytë, janë Ministrinë e Bujqësisë, të cilat përdorin produktin për të mbrojtur të Kulturat bujqësore në vende të ndryshme.



Se fundi, në këtë plan, janë dhe një numër tepër i madh biznesmenësh, si industrialistë ashtu dhe fermerë, të cilët kanë përfituar prej produktit. Në planin internacional, në raste të ndryshme, përdorimi i Biorat ka marrë mbështetjen e Organizatës Panamerikane të Shëndetit (OPS), të

Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara të Bujqësisë dhe Ushqimit (FAO)

Përdorimi i BIORAT në vende të tjera ecën në rrugë të ngjashme me ato të produkteve biologjike.

Adoptimi i Biorat në vendet e tjera

Përdorimi Biorat në vende të tjera

PER PERDORIMIN E BIORAT NEPERMJET IMPORTIMIT TE TIJ NE VEND

Për përdorimin e Biorat nëpërmjet importimit të tij në vendin korespondues, ecuria e procedurave është si më poshtë:



- Identifikimi dhe rënia dakort me një njësi lokale që të jetë e akredituar për importimin e këtij tip produkti, si dhe për të bërë kërkesën për regjistrimet koresponduese në vend
- Firmosja e dokumentave të mëposhtme midis Labiofam S.A. dhe kësaj njësie: Kontrata e prezantimit.
Marrëveshja e konfidencës.
Autoritet për të prezantuar Labiofam S.A. përpara autoriteteve të regjistrimit
- Dorëzimi nga ana e Labiofam S.A. tek njësia e dokumentave të nevojshme
- Realizimi i regjistrimit sanitar dhe i markës në vendin e interesuar. Në përgjithësi, edhe pse mund të ndryshojë nga një vend në tjetrin, këto janë në varësi të Ministrive të Shëndetësisë dhe të Bujqësisë, të cilat janë të ngarkuara për të pritur kërkesat që bëhen, t'i analizojnë ato dhe t'i aprovojnë.
- Komercializimi i produktit.

Kanë ekzistuar raste në të cilat, për nevoja sanitare të urgjencës, Qeveritë kanë dhënë autorizime të përkohshme për komercializimin e produktit pa qenë e nevojshme të plotësohen hapat 3, 4 dhe 5.



PER FABRIKIMIN E PRODUKTIT NE VEND

Një variant tjetër konsiston në fabrikimin e produktit në vendin e interesuar, për të cilin, pasi janë kaluar hapat e përcaktuara me kujdes të lartë, kërkohet krijimi i një forme shoqate ekonomike me një njësi lokale. Vazhdohet me hapat e mëposhtme:

- Zhvillimi i një studimi tregu, duke u nisur nga territori në të cilën duhet të zhvillohet komercializimi, duke përcaktuar kështu madhësinë e instalimit prodhues, si dhe kërkesat teknike.
- Zhvillimi i studimit mbi faktorin ekonomik që vlerëson në këtë mënyrë vlefshmërinë e projektit, si dhe kapitalin që nevojitet për të investuar në të.
- Negocimi dhe marrëveshja midis palëve në lidhje me detyrat që duhet të realizojnë palët për të krijuar shoqatën.
- Zhvillimi dhe diskutimi i dokumentave legale që nevojiten për themelimin e shoqatës, ashtu si dhe normat e administrimit të kontrollit dhe drejtimit që do të ndjekin shoqatën.
- Aprovimi nga ana e autoriteteve kompetente të vëndeve të përfshira, të projekteve të investimit dhe asocimit. Në këtë kuptim, në përgjithësi ndërhyjnë organizmat të cilat janë të ngarkuara me investimet e huaja, të shkencës dhe teknologjisë, të ndërtimit, të pronësisë dhe të Bankës Qëndrore.
- Ekzekutimi i investimit.
- Vënia në punë e ndërmarrjes së re.

Nga pikpamja kulturore, shkencore dhe teknike, nuk kërkohen kushte speciale për përdorimin e produktit. Si normë pune, LABIOFAM përfshin brënda paketës jo vetëm dozimin thjesht të produktit, por dhe asistencën teknike të nevojshme për të mbështetur përfaqësuesin me specialistë në procesin e regjistrimit dhe të demonstrimit si në laborator ashtu dhe në fushë. LABIOFAM garanton si përgatitjen e personelit që aplikon produktin ashtu dhe të supervizionit “in situ” të punve të aplikimit.

Në rastin në të cilin krijohet një shoqatë me objektivin e prodhimit dhe të komercializimit të produktit në vendin e interesuar, kërkohet disponibiliteti i specialistëve dhe teknikëve në fusha të tilla si mikrobiologjia, biokimia dhe analizave fiziko-kimike të laboratorëve, si dhe disponibiliteti për teknik dhe punonjës në degë të tilla si mekanike dhe elektrike.

Në disa vende, duhet të kihet parasysh fakti se disa besime të caktuara fetare janë të lidhura me miun, dhe për këtë arsye konsiderohet me karakteristika të vëcanta. Ky rast duhet të ketë një trajtim të veçantë sipas traditave të vendit.

Njësia Kubane që aktualisht zhvillon prodhimin dhe komercializimin e BIORAT është Grupi i ndërmarrjeve LABIOFAM nëpërmjet shoqërisë së saj tregëtare Labiofam S.A.

Si u tha dhe më sipër, në procesin e përdorimit të produktit, LABIOFAM zotëron fuqinë e nevojshme për të dhënë asistencën teknike që kërkohet si në procesin e regjistrimit, të specializimit të personelit ashtu dhe në shërbimet e post-shitjes (pas shitjes)





Për me shume informacion

LABIOFAM S.A. zotëron një literature të pasur të përfutur përgjate kohës që ka punuar me Biorat, dhe përbëhet në terma të përgjithshme nga:

- Studime klinike mbi mosrezikshmërinë e Biorat, si tek njerëzit ashtu dhe mbi disa specie të ndryshme kafshësh.
- Rezultate të provave laboratorike dhe demonstrime në fushë të Biorat-it.
- Rezultate të fushatave të aplikimit të produktit në vende të ndryshme
- Karta njohje të njërive të ndryshme nacionale dhe internacionale
- Dosje shkencore të produktit.

Kë të kontaktojmë?

Nëse dëshironi të zgjeroheni më shumë në lidhje me këtë aspekt mund të gjeni informacion duke u drejtuar tek adresat e mëposhtme:

Dr. José A. Fraga Castro, Presidente, (Grupi i Ndermarrjeve LABIOFAM)
Grupo Empresarial Labiofam.

Ave. Rancho Boyeros, Km. 16 __, Boyeros, Ciudad de la Habana, Cuba
Tel.: (537) 33 20 63; Fax: (537) 33 57 48; e-mail: labiofam@ceniai.inf.cu

Dr. Antonio Casas Saún, ZvPresidenti Ekzekutiv, Labiofam S.A.

Calle 34 # 3407, Rpto. Kohly, Playa, Ciudad de la Habana, Cuba
Tel.: (537) 204 21 85; Fax: (537) 204 21 81; e-mail: postmaster@labnet.com.cu

Ing. Daniel J. Morhaim, Zvpresident I Dyqaneve, Labiofam S.A.

Calle 34 # 3407, Rpto. Kohly, Playa, Ciudad de la Habana, Cuba
Tel.: (537) 204 21 69/70/71/75/77/78; Fax: (537) 204 21 81
e-mail: negocios@labnet.com.cu



Iniciativa IDEASS — Inovacione për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Jug — Jug është promovuar nga programet e mëposhtme për bashkëpunim ndërkombëtar: ILO/Universitas, UNDP/APPI, dhe UNDP/ IFAD/UNOPS Programet për Zhvillim Njerëzor dhe Programet Kundër Varfërisë, aktualisht prezente në Shqipëri, Angola, Kolumbi, Kubë, El-Salvador, Guatemalë, Honduras, Mozambik, Nikaragua, Republikën Domenikane, Serbi, Afrikën e Jugut e Tunizi. Iniciativa e bashkëpunimit është rezultat i Samiteve Botërore në vitet 1990 dhe i Asamblesë së Përgjithshme të Mileniumit; ajo i jep përparësi bashkëpunimit mes protagonistëve në Jug, me mbështetjen e vendeve të industrializuara.

Qëllimi i IDEASS është të forcojë efektivitetin e proceseve të zhvillimeve lokale përmes përdorimit në rritje të inovacioneve për zhvillim njerëzor dhe kushte të mira pune. Përmes projekteve të bashkëpunimit jug-jug, ata veprojnë si një katalizator për përhapjen e inovacioneve sociale, ekonomike dhe teknologjike që favorizojnë zhvillimin ekonomik dhe social në nivel lokal. Inovacionet e promovuara mund të jenë produkte, teknologji, ose praktika sociale, ekonomike, ose kulturore. Për më tepër informacion rreth Iniciativës IDEASS vizitoni faqen e internetit: www.ideassonline.org



ideass

Inovacione për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Jug - Jug



Programi i PNUD-it Iniciativat e Partneritetit Kundër — Varfërisë (APPI) është një program i projektuar për të ndihmuar qeveritë dhe aktorët socialë për të vendosur dhe zbatuar politika kombëtare për uljen e varfërisë dhe përjashtimit social, bazuar në praktikën e zhvillimit të integruar dhe gjithëpjesëmarrës në nivel lokal.



Programet për zhvillim njerëzor dhe kundër varfërisë të zbatuara UNDP, IFAD, ILO, dhe UNOPS përkrahin proceset e zhvillimit lokal të integruar dhe gjithëpjesëmarrës brenda kornizës së politikave kombëtare, me mbështetjen e aktoreve publike, private, dhe shoqëris civile. Këto programe sigurojnë kornizën brenda së cilës vendet dhuruese dhe komunitetet në vendet e industrializuara mund të bashkëpunojnë në mënyrë të organizuar, përmes bashkëpunimit të decentralizuar. Brenda kësaj kornize do të realizohen dhe bashkëpunimet jug — jug përmes Iniciativës.



Programi ILO/Universitas (punë korrekte përmes trajnimit dhe inovacionit) inkurajon përdorimin e zgjidhjeve inovative të problemeve në zhvillimin njerëzor, veçanërisht në botën e punës. Për të arritur këtë, ai kryen veprimtari kërkimore dhe trajnon vendim-marrësit dhe personelin që punon për zhvillimin lokal.



Në Shqipëri, IDEASS është një iniciativë e programit PASARP (Programi i Aktiviteteve në Mbështetje të Qarqeve dhe Prefekturave Shqiptare), realizuar nga IFAD/UNOPS me fondet e bashkëpunimit italian.